



REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERËVE VLORË
NOTERE JETMIRA Xh. VERAJ

Vlorë, më 11.03.2021

Repertori Nr.308

Koleksioni Nr.163/ 2

DËSHMI TRASHËGIMIE LIGJORE

Në Vlorë sot në datë 11 mars 2021 (dymijë e njëzet e një), para meje Noteres JETMIRA Xh. VERAJ, regjistruar në Dhomën e Noterëve Vlorë, në Zyrën time Noteriale në Vlorë – Bulevardi "Ismail Qemali", Kryqëzimi i Kalit të Trojës, Nd.88, H.16, N.2, u paraqit personalisht shtetasi shqiptar: ---

AUREL SALATI, i biri i Vladimirit dhe Terezës, lindur në Vlorë më 06.10.1980 dhe banues në Vlorë në lagjen "David Selenicasi" Nd.10, H.10, Ap.30; me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur prej meje Noteres, pajisur me letërnjoftimin Nr.034584980. --

I paraqituri kërkoi lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin VLADIMIR SALATI.

Pasi shqyrtova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur prej kërkuesit AUREL SALATI për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin VLADIMIR SALATI

KONSTATOJ

se kërkuesi AUREL SALATI është djali i të ndjerit VLADIMIR SALATI dhe legjitimohet të paraqesë kërkimin pranë kësaj Zyre Noteriale.

Meqënëse vëndbanimi i fundit i trashëgimlënësit VLADIMIR SALATI rezulton të ketë qënë në Vlorë, në bazë të nenit 348 të Kodit Civil aktual kjo zyrë ka kompetencën të shqyrtojë kërkesën.

Në lidhje me pretendimin e kërkuesit, prej meje Noteres u kërkua:

1. të përcaktohen trashëgimtarët e të ndjerit VLADIMIR SALATI
2. të përcaktohen pjesët takuese të secilit prej tyre.

Sipas çertifikatës së vdekjes lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr.417 të Bashkisë Vlorë rezulton se në datë 10.02.2021 ka vdekur trashëgimlënësi VLADIMIR SALATI, i biri i Ramadanit dhe Teftës, lindur në Elbasan më 26.06.1948, me gjëndje civile i martuar, me shtetësi shqiptare dhe banesë në momentin e vdekjes në Rajonin Nr.3 – Vlorë.

Në bazë të nenit 318 të Kodit Civil ndryshuar me ligjin Nr.121/2013 që parashikon se «... trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur...» ligji i zbatueshëm në rastin konkret është ligji Nr.7850 datë 29.07.1994 «Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë» i ndryshuar.

Në bazë të parashtrimeve të kërkuarit AUREL SALATI dhe verifikimeve në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve nuk rezulton që i ndjeri VLADIMIR SALATI të ketë disponuar me testament pasurinë e tij, për pasojë në bazë të nenit 317 të Kodit Civil do të zbatohet trashëgimia ligjore.

Në bazë të nenit 361 të Kodit Civil aktual "...në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta..."

Nga çertifikatat e paraqitura rezulton se i ndjeri VLADIMIR SALATI ((ndryshuar mbiemrin nga SALATAJ në SALATI me procesverbalin Nr.173 datë 05.12.2002) ka qenë i martuar me TEREZA JAZO (ndryshuar mbiemrin me martesë në SALATAJ dhe me procesverbalin Nr.173 datë 05.12.2002 ndryshuar nga SALATAJ në SALATI), e bija e Haredinit dhe Xhografisë, lindur në Vlorë më 20.02.1956 dhe nga kjo martesë kanë lindur dy fëmijë: ---

- djali ERDIN SALATAJ ((ndryshuar mbiemrin në SALATI me procesverbalin Nr.173 datë 05.12.2002), lindur në Vlorë më 10.06.1977 dhe banues në Rrugën "Andon Zako Cajupi" Nd.013, H.1, Ap.132 Tiranë, me gjëndje civile i martuar, shtetas shqiptar me numër personal H70610112T. ----

- djali AUREL SALATAJ ((ndryshuar mbiemrin në SALATI me procesverbalin Nr.173 datë 05.12.2002), lindur në Vlorë më 06.10.1980 dhe banues në lagjen "David Selenicasi" Nd.10, H.10, Ap.30 Vlorë, me gjëndje civile i martuar, shtetas shqiptar me numër personal I01006085V. ----

Nga çertifikatat e paraqitura rezulton se bashkëshortja dhe fëmijët e të ndjerit kanë qenë gjallë në kohën e vdekjes së tij dhe janë gjallë edhe sot; si rrjedhojë përfshihen në rrethin e trashëgimtarëve të tij. ----

Kërkuari AUREL SALATI ka parashtruar nën përgjegjësinë e tij personale dhe ligjore se asnjë nga trashëgimtarët e mësipërm nuk ka hequr dorë nga trashëgimia dhe nuk është bërë i padenjë për të trashëguar.

Gjithashtu nga deklaratimet e kërkuarit dhe dokumentacioni i paraqitur, nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë pasur martesë të mëparshme apo fëmijë të tjerë jashtë martese apo të birësuar.

Bazuar në sa më sipër, trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit VLADIMIR SALATI rezultojnë bashkëshortja TEREZA SALATI dhe fëmijët ERDIN SALATI e AUREL SALATI, të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga 1/3 pjesë secili të pasurisë trashëgimore dhe mbartin detyrimet e saj në të njëjtën masë.

PËR KËTO ARSYE

në bazë të nenit 348 të Kodit Civil dhe nenit 62/1 gërma "f" e ligjit ligjit Nr.110 datë 20.12.2018 "Pë Noterinë"

V E N D O S A

te lëshoj dëshminë e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin VLADIMIR SALATI lindur në Elbasan më 26.06.1948 dhe vdekur në datë 10.02.2021, duke përcaktuar trashëgimtarë të tij trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë:

1. TEREZA SALATI - lindur në Vlorë më 20.02.1956, numri personal F65220226T,

bashkëshortja. ---

2. ERDIN SALATI - lindur në Vlorë më 10.06.1977, numri personal H70610112T, i biri. ---
3. AUREL SALATI - lindur në Vlorë më 06.10.1980, numri personal I01006085V, i biri. ---

të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga 1/3 pjesë secili mbi pasurinë trashëgimore dhe përgjigjen për detyrimet e saj në të njëjtën masë.

Ky akt përpilohet në tre kopje nga të cilat një i dorëzohet kërkuesit (duke i bërë të qartë detyrimin për depozitimin e këtij akti në ZVRPP Vlorë brenda 30 ditësh nga data e sotme) dhe një kopje arkivohet pranë kësaj zyre.

NOTERE / JETMIRA Xh. VERAJ



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]